Përkthim nga gjuha rumune

SHËNIME INFORMIMI PËR MBROJTJEN DHE PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE ME KARAKTER PERSONAL

Adresa e zyrës qendrore: Str. Occidentului nr. 3, et. 2,
Kodi postal 010981, Sector 2, Bukuresht, Rumani

PARIMET E PËRPUNIMIT*:* Përpunimi i të dhënave me karakter personal, me të cilat hyjmë në kontakt, të cilat i kemi në dispozicion dhe/ose na janë besuar neve, zhvillohet duke ndjekur parimet drejtuese të Rregullores së Bashkimit Europian me nr. 679/2016, midis të cilave mund të përmendim si më poshtë :

- Parimi i ruajtjes së konfidencialitetit që nga momenti i kontaktit të parë me të dhënat me karakter personal ;
- Parimi i ruajtjes së konfidencialitetit në secilën etapë/aktivitet të përpunimit/procesimit të të dhënave me karakter personal ;
- Parimi i transparencës dhe i drejtësisë;
- Parimi i mbajtjes së kontrollit mbi të dhënat e tua me karakter personal;
- Parimi i kufizimit të qëllimit si dhe i atij të legalitetit të operacioneve të përpunimit të të dhënave me karakter personal;
- Parimi i ruajtjes së sigurisë dhe integritetit të të dhënave me karakter personal që procesohen, si në formë dixhitale, ashtu edhe në formë të shtypur;

Mbrojtja e informacioneve që ju na i furnizoni ose që na furnizohen për ju e konsiderojmë një element të rëndësishëm për zhvillimin e aktivitetit dhe duam që t'ju sigurojmë se këto të dhëna i përdorim duke i trajtuar me prioritet në kuadrin e aktiviteteve që ne ndërmarrim, të cilat presupozojnë procesimin e të dhënave me karakter personal (që në vazhdim do t'I quajmë me shkurtimin: DCP (DHKP - të dhëna me karakter personal).

Në reshtat e mëposhtëm do t'ju komunikojmë një seri gjërash, për të cilat konsiderojmë se duhet të keni dijeni, sepse lidhen me informacionet që ne mbledhim, me bazën ligjore që ne përdorim, me qëllimin për të cilat ne i mbledhim të dhënat, me mënyrën se si i përdorim këto të dhëna, për çfarë arsye I mbledhim dhe me kë i ndajmë këto të dhëna.

KUADRI LEGJISLATIV

Duke respektuar parashikimet ligjore kombëtare dhe europiane, dhe pikërisht Rregulloren (UE) të bahskimir Europian me nr. 679/2916 që lidhet me mbrojtjen e të dënave me karakter personal si dhe me qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave, por edhe dhe normat e aplikimit të dispozitave në legjislacionet kombëtare, dhe në bazë të Ligjit 190/2018, të dhënat tuaja me karakter personal procesohen në përputhje me Politikën e Konfidencialitetit që parashikon mbrojtjen e të dhënave me karakter personal kur këto përdoren me qëllimin e përpunimit të këtyre të dhënave, rë procedurave dhe proceseve të brendlëshme të punës, të cilat aprovohen

nga faktorët vendimarrëse të shoqërisë iSense Solutions Research SRL (SH.P.K.) (organizatë që do të quhet në vazhdimësi iSense).

Duke respektuar parashikimet ligjore kombëtare dhe europiane, si dhe ato që u nënvizuan në pjesën e fillimit të këtyre shënimeve informative, dëshërojmë t'ju bëjmë me dije faktin se të dhënat tuaja me karakter personal procesohen në konformitet me legjislacionin në fuqi, por edhe në përputhje me Politikën e Konfiedencialitetit që lidhet me mbrojtjen e të dhënave me karakter personal që përdoren me qëllimin e përpunimit të këtyre të dhënave, të procedurave dhe proceseve të brendëshme të punës , që janë aprovuar nga faktorët vendimmarrëse të iSense apo nga përfaqësuesit legalë të fuqizuar/të autorizuar nga iSense.

Duam t'ju njoftojmë faktin se kjo Politikë e Konfidencialitetit mund të modifikohet në çdo moment, ndërkohë që aktualizimet dhe modifikimet e Politikës së Konfiedencialitetit bëhen të vlefshme menjëherë mbas njoftimit dhe/ose mbas publikimit të këtyre ndryshimeve, të cilat do të afishohen në portalin www.SensePanels.com. De nëse është e nevojshme, do t'ju njoftojmë për këto modifikime përmes adresës suaj t e-mail, adresë të cilën na I keni dhënë paraprakisht.

Detajet e kontaktit të iSENSE

Detajet e kontaktit të iSense, siç është e quajtur në vazhdimësi organizata që identifikohet me emrin *Shoqata iSense Training Center*, të dhënat e kontaktit të së cilës mund të gjehen në formë të detajuar në reshtat e mëposhtëme , por edhe në kuadër të website-it: www.iSenseSolutions.ro, i mkonsideruar në vazhdimësi **operator i të të dhënave**, sipas parashikimeve ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave me karakter personal, mban përgjegjësi për përpunimin e të dhënave tuaja që kanë karakter personal, si në rastin kur të dhënat tuaja personale janë mbledhur direkt nga ju ose kur këto të dhëna janë mbledhur nga burime të tjera të jashtme *(suplementare*):

Adresa e zyrës qendrore: Bukuresht, str. Occidentului nr. 3, et. 3, kosi postal 010981, Sector 2, Bukuresht – Rumani (tek godina Ivy Office)
Të dhëna kontakti : contact@SensePanels.com

Sigla

Cilat janë të dhënat identifikuese të organizatës që ju proceson të dhënat me karakter personal ?

Të dhënat identifikuese të organizatës janë: iSENSE Solutions International SRL (SH.P.K.), me zyrë qëndrore në godinën me zyra *IVY office*, str. Occidentului nr. 3, et. 3, kodi postal 010981, Sector 2, Bukuresht – Rumani, e regjistruar në Regjistrin e Tregëtisë me nr. J40/11410/17/09/2015, me kod unik të identifikimit fiskal RO35015004, me përfaqësues ligjor administratorit.

Të dhëna kontakti DPO – iSENSE

Në rastin se do të keni nevojë për informacione suplementare, jeni të lutur të mos hezitoni që të na kontaktoni, rekomandimi ynë është që të përdorni të dhënat e kontaktit të oficerit i ngarkuar me mbrojtjen e të dhënave *(funksion i cili quhet në formë të shkurtuar DPO)*, të cilin e kemi emëruar në kuadër të iSENSE dhe i cili do t'ju përgjigjet juve në afatin më të shkrtër të mundur, deri në afatin prej 30 ditësh. Të dhënat e kontaktit të DPO-së iSENSE janë si më poshtë:

Nëpërmjet e-mail: dpo@sensepanels.com
Adresa për korespondencën me shkrim: str. Occidentului nr. 3, et. 3, kosi postal 010981, Sector 2, Bukuresht – Rumani.

Lloji i të dhënave të mbledhura

Përpunojmë këto lloj të dhënash me karakter personal që ju na i keni dhënë ose të dhënat që na janë furnizuar për ju – informacione që do t'i quajmë në vazhdimësi "***Të dhëna me karakter personal***" (që quhen me shkurtimin DCP) si më poshtë:

- Mbiemër, emër, seksi, vit I lindjes dhe kodi postal, adresa e e-mail, data e lindjes, mosha (të cilat do të quhen në vazhdimësi "***Të dhëna personale";***

- Të dhënat shtesë , duhen në rastin e personave që regjistrohen ose janë aktivë në kontin/ llogarinë e platformës dhe u përgjigjen një sërë pyetjeve suplementare gjatë procesit të kompletimit të profilit të përdoruesit, të cilat na ndihmojnë për të dërguar ftesat për studimet në funksion të profilit të përdoruesit të platformës si dhe në funksion të kategorisë së pjesëmarrësit, të cilët janë të ftuar për një tip të caktuar studimi të tregut (i cili mund të jetë I llojeve të ndryshme dhe që do të quhet përgjatë këtij dokumenti "studim"), do të mund të përpunojmë edhe të dhënat që tregojnë nivelin e shkollimit, profesionin, faktin nëse është drejtues automjeti auto apo jo, markën e makinës që drejton ose që ka pasur, të dhëna mbi preferencat (për shembull, preferencat për prodhime të ndryshme ushqimore që konsumojnë dhe/ose që janë të preferuara, prodhimet fast-food që konsumojnë dhe/ose që preferojnë, hobby-et dhe interesat, preferencat për objektet elektronike/elektroshtëpijake, për kompjuterat apo për lojrat video, për udhëtimet, nëse janë konsumatorë të pirjes së duhanit), informacione të cilat përmbajnë të dhëna me karakter personal dhe që mund të konsiderohen si të tilla, ashtu siç janë të përcaktuara në Rregullore dhe të cilat mund t'i kosiderojmë komponente të kategorisë së titulluar *"Të dhëna personale*" ;

- E RËNDËSISHME: Përgjatë procesit të plotësimit të detajeve të profilit si përdorues në bazë të përgjigjeve që do t'u jepni pyetjeve suplementare shtesë, por edhe me rastin e pjesëmarrjes në studime të ndryshme, mund të përpunohen edhe të dhëna me karakter personal më delikate dhe të ndjeshme si më poshtë: origjina racore ose ajo etnike, opinionet politike, përkatësia fetare ose idete filozofike, nëse keni cilësinë e anëtarit të ndonjë sindikate, të dhëna që lidhen me gjendjen shndetësore apo me jetën seksuale, duke qenë se ketë janë informacione që përmbajnë të dhëna me karakter personal dhe mund të futen në kategorinë si e të dhenave personale të quajtura "*Të dhëna Personale*", me regjim special.

- data dhe ora e pjesëmarrjes në studim dhe/ose data apo intervali I kohës gjatë të cilit është kryer studimi, shkalla e plotësimit të studimit, përqindja e inkuadrimit në profilin e përdoruesit që është I përshtatshëm për një lloj studimi të caktuar, tematika e studimit (të quajtura në vazhdimësi "***Të dhëna që I referohen studimit"*** dhe të cilat I referohen përgjigjeve që ju ofroni gjatë plotësimit të pyetsorëve të aksesuara dhe të plotësuara në kuadrin e studimeve);

- Të dhëna suplementare: në rastin e të dhënave që ofrohen si rezultat i dhënies së përgjigjeve në pyetsorët e studimit, në të cilat përdoruesi i platformës merr pjesë dhe që përdoren për raportimin e rezultateve të sondazheve, në një format që ruan anonimatin e përdoruesit *(kjo do të thotë që personave të tretë nuk u lejohet të identifikojnë identitetin e përdoruesit që ka dhënë përgjigjen , që ka marrë pjesë në sondazh dhe/ose në studimin e tregut)*, mund të përfshihen edhe llojet e informacioneve në vazhdim: të dhëna mbi zakonet dhe preferencat e objeketve të konsumit si dhe preferencat që lidhen me lloje të ndryshme të prodhimeve masmedia, që lidhen me zonën auto, me konsumin në përgjithësi, me ushqimet, pushimet dhe me aktivitetet në kohën e lirë, me prodhimet dhe shërbimet mjeksore, në lidhje me mbajtjen dhe përdorimin e dispozitivëve që janë të konektuara me internetin; informacione që lidhen me preferencat ndaj markave dhe prodhimeve të caktuara. Akumulimi i këtyre informacioneve mund t'i konsiderojmë komponente të kategorsië "*Të dhëna që lidhen me studimin*";

- E RËNDËSISHME: në disa raste, përsa I përket dhënies së përgjigjeve të pyetsorëve të disa studimeve të tregut, në të cilat përdoruesi I platformës bën zgjedhjen për të marrë pjesë, mund të përpunohen disa të dhëna të caktuara me karakter personal të ndjeshme dhe delicate, siç janë origjina racore apo etnike, opinionet politike, përkatësia fetare ose idetë filozofike, nëse keni cilësinë e anëtarit të ndonjë sindikate, apo të dhëna që lidhen me gjendjen shndetësore apo me jetën seksuale, informacione që përmbajnë dhe që mund të konsiderohen komponente të kategorisë të quajtur *"Të dhëna që I referohen studimit",* që kanë një regjim special;

Vërejtje: përdoruesi I platformës nuk është i detyruar t'u përgjigjet pyetjeve të cilat mund të japin informacione që përmbajnë të dhëna me karakter personal. Këto lloj pyetjesh do të përmbajnë gjithnjë edhe opcionin "*preferoj të mos përgjigjem*". Të gjitha përgjigjet e këtyre lloj pyetjeve do të mbeten konfiedenciale, duke përjashtuar rastet kur përdoruesi I platformës e shpreh në mënyrë shumë të qartë dakortësinë që përgjigjet e dhëna prej tij, të cilat mund të përmbajnë edhe të dhëna të tjera me karakter personal, ashtu siç janë përcaktuar më sipër, që këto t'u dërgohen klientëve të fushës që studjohet, për t'iu nënshtruar një analize më të hollësishme.

- të dhënat identifikuese të dokumentit të identitetit, adresa për faturimin/hartimin e dokumentit që është i nevojshëm për kryerjen e shpërblimit, informacione të karakterit financiar (numri i llogarisë bankare IBAN) bankën, titullarin e llogarisë bankare dhe/ose emrin e përdoruesit të llogarisë bankare, platformën *efinance*, adresa e e-mail-it që përdor) (të cilat do të quhen në vazhdimësi "***Të dhëna referuse mbi pagesën";***

- Preferenca: kontakti/ komunikimi, adresa e e-mail-it, nr. i telefonit celular dhe/ose telefonit fiks, adresa ku do të mbahet korespondenca (ku të përfshihet rrethi dhe kodi i postes që I shtohet adresës), përmbajtja e mesazhit të komunikuar/të dërguar si dhe subjekti i këtij mesazhi,

përmbajtja e dokumenteve të bashkangjitura që i dergohen iSENSE (të quajtura në vazhdimësi ***"Të dhëna komunikimi");***

- Informacione për personat që kanë cilësinë e një përdoruesi potencial të platformës, përkatësisht cilësinë e përdoruesit, detaje që lidhen me përdorimin e portalit www.sensepanels.com nga ana juaj (për shembull, data dhe ora kur keni aksesuar portalin www.sensepanels.com), duke shtuar edhe adresën IP publike që ju keni përdorur, device ID public si dhe të dhëna të ngjajshme që lidhen me ju , (për shembull, tregues të ndryshëm teknikë siç mund të jetë koha që keni kaluar në kuadër të website-it, zonat që keni aksesuar në kuadër të portalit) (të quajtura në vazhdimësi ***"Të dhëna statistike"***).

MËNYRA TË MBLEDHJES SË INFORMACIONEVE

Meqënëse përpunimi I të dhënave me karakter personal që ju përkasin juve është një detyrim ligjor që na lejon të zhvillojmë aktivitetin për vënien në dispozicionin tuaj të prodhimeve dhe/ose të shërbimeve që ju dëshëroni t'i kontraktoni nga ne, por edhe për faktin se përpunimi I këtyre të dhënave na lejon që të përmirësojmë prodhimet dhe shërbimet tona që ne ju ofrojmë, sepse na ndihmojnë që të procesojmë kërkesat sa më shpejt të jetë e mundur dhe të menaxhojmë në mënyrë efiçiente marrëdhëniet me ju, dëshërojmë që t'ju informojmë për mënyrat me të cilat ne mbledhim të dhënat me karakter personal, kurse në listen e mëposhtëme do mundohemi të japim shëmbuj mbi një pjesë të mënyrave me të cilat ne mbledhim këto të dhëna. Por në disa raste speciale, do të apelojmë edhe në metoda të tjera, të ndryshme nga to që theksohen në listën e mëposhtëme:

- të dhënat do të merren direkt nga ju (*nëpërmjet plotësimit të regjistrimit që duhen në portalet online dhe nëpërmjet të cilit mund të kryejmë shërbimet e kontraktuara, të dërguara me e-mail, të dërguara me letër të shkruar, me SMS, nëpërmjet rjeteve sociale apo nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit të dëshiruara);*

- nëpërmjet raporteve të trafikut të regjistruar nga server-at që përmajnë website-in iSense ose në kuadër të server-ave apo dispozitivëve apo nëpërmjet zgjidhjeve software që formojnë sistemin informatics të iSENSE;

- nëpërmjet platformave online të tipit të rjeteve sociale (për shembull, Instagram, Twitter, Facebook, si dhe nëpërmjet cookie-ve)
- të dhëna që merren nga partenerë të tretë, të cilët na komunikojnë të dhëna për kryerjen e shërbimeve në një nivel cilësie që dëshirojmë (për shembull, që të mos kufizohemi tek furnizuesit e shërbimemeve të marketing-ut) ose për të përmitrësuar prodhimet dhe/ose shërbimet në përputhje me kërkesat tuaja (për shembull, që të mos kufizohemi tek furnizuesit e studimit të tregut); në rastin kur marrim këto lloj informacionesh, do të përmbushim detyrimin ligjor për t'iu informuar në njëafat prej 30 ditësh që nga dita e ndërmarrjes së këtij demarshi.

Përveç kësaj, me dakortësinë tuaj paraprake (të cilin mund ta tëhiqni në çdo moment, pa asnjë kosto për ju, vetëm duke bërë një kërkese të thjeshtë drejtuar ekipit të projektit iSENSE, në mënyrë të veçantë personit përgjegjës që merret me mbrojtjen e të dhënave në kuadrin iSense), mund të përpunojmë, gjithashtu, të dhënat me karakter personal që ju përkasin edhe për:

- t'ju transmetuar lejmërime publiciteti të personalizuara për prodhimet apo shërbimet tona apo të partenerëve/furnizuesve dhe/ose bashkëpunëtorëve tanë, për të cilët mendojmë se keni interes.
- për t'ju ofruar eksperianca të personalizuara;
- që të mund të realizojmë sondazhe tregu (për shembull, për të mos u kufizuar vetëm tek sondazhet të kënaqshme për klientët);
- që të mundemi t'ju aktivojmë disa lehtësira që ju do të dëshironit t'I kishit gjatë aktiviteteve që zhvillon iSense;

MËNYRA, PËRDORIM, TË DHËNA TË MBLEDHURA

Në listën e mëposhtëme mund të detajojmë disa nga mënyrat se si mund të përdoren informacionet që mund të konsiderohen të dhëna me karakter personal:

- për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në sondazhe nga fusha e shëndetësisë;

- për kriijimin e profilit të përdoruesit në portalin e iSense;

- për shpërblimin e përpjekjeve/aktiviteteve që ndërmerren në kuadrin e portalit iSense, në përputhje me Rregulloren e zhvilllimit të aktivitetit;

- në mënyrë që iSense të konformohet me dispozitat ligjore që aplikohen në aktivitetet e saja;

- në përpjekjen tonë ose të partenerëve tanë ose të furnizuesve tanë për t'u siguruar që mund t'ju kontaktojmë pa vështirësi dhe në mënyrë profesionale;

- që të mund t'ju vëmë në dispozicion informacione të cilat I keni kërkuar;

- që t'ju vëmë në dispozicion prodhimet apo shërbimet që na I keni kërkuar;
- që të mund t'ju dërgojmë informacione të rëndësishme që lidhen me prodhimet dhe shërbimet tona;

- që të mund të masim performancën e kompanive tona të publicitetit, si në rastin që i zhvillojmë ne këto performanca, në mënyrë direkte, nëpërmjet personelit të brendëshëm të punësuar, ashtu edhe kur këto kryhen në mënyrë jo direkte, përmes partenerëve/furnizuesve të kontraktuar;

- që të mund të masim performancën e shërbimeve tona të shitjes apo edhe mbas shitjes;

PERIUDHA E RUAJTJES SË TË DHËNAVE TË MBLEDHURA

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitoruu periudhat maksimale gjatë së cilës do të stokojmë të dhënat tuaja me karakter personal. Kjo periudhë mund të zgjatet në rastin kur jemi të detyruar nga pikëpamja e respektimit të legjislacionit në fuqi ose vetëm me dakortësinë tuaj për zgjatjen e këtij afati.

Mbas skadimit të kësaj date, në rastin kur nuk e kemi marrë aprovimin tuaj për të zgjatur periudhën e ruajtjes së të dhënave tuaja me karakter personal, këto të dhëna do të transformohen në të dhëna statistikore, duke kaluar në anonimat, ose, sipas rastit, do të fshihen në siguri të plotë.

Kategoria e përpunimit të të dhënave me karakter personal

Menaxhimi i marrëdhënieve me përdoruesit, dërgimi I informacioneve të rëndësishme për përpunimin e të dhënave me karakter personal, komunikimi i informacioneve të nevojshme si rrjedhojë e pjesëmarrjes në studime, matja e performances së kompanive të promovimit, shërbime shitjeje dhe mbas-shitjeje.

Kryerja e sondazheve për të matur nivelin e sadisfakcionit të përdoruesve të regjistruar në platformën iSense.

Ruajtja e dokumenteve financiare dhe të kontabilitetit si dhe e shkresave të tjera që janë të nevojshme për t'u përshtatur me parashikimet ligjore në këtë fushë.

Ruajtja e dokumenteve finaciare dhe të kontabilitetit dhe e shkresave të tjera që janë të nevojshme për t'u përshtatur me parashikimet ligjore të fushës.

Periudha e stokimit

5 vjet është periudha e stokimit të të dhënave për përdoruesit e regjistruar, 2 vjet për personat propsektë (që quhen përdorues it që e kanë filluar procesin e regjistrimit në kuadrin e portalit iSense, por që më pas nuk e kanë përfunduar këtë proces).

2 vjet që nga momenti i mbylljes së sondazhit.

10 vjet që nga data e lëshimit të dokumenteve përkatëse.

10 vjet që nga data e lëshimit të dokumenteve përkatëse.

Legaliteti i përpunimit të të dhënave me karakter personal (DHKP)

Të dhënat me karakter personal që janë të përpunuara në përputhje me ligjin nga përfaqësuesit dhe/ose nga personat e autorizuar të iSense, në kontekstin e furnizimit të prodhimeve dhe/ose të kryerjes së shërbimeve të kontraktuara, por edhe të dhënat të marra gjatë procesit të komunkimit, duke përfshirë edhe ato në hapsirën online, apo në rastin e dhënies së përgjigjes gjatë kërkimit të një oferte, gjatë kompletimit të formularëve online, për përmitësimin e shërbimeve, përmes abonimit tek Newsletter apo kur këto të dhëna furnizohen në një mënyrë tjetër, duke përdorur website-in ose në kuadrin e marrëdhënieve me iSense, mund të përpunohen në mënyrë direkte ose me ndërmjetësinë e personave të fuqizuar/autorizuar, sipas qëllimeve dhe kushteve të mëposhtëme:

1. Në qoftë se vizitoni websit-in e iSense, do t'i procesojmë të dhënat tuaja personale në mënyrën e përshkruar më poshtë:

1. A. Për më shumë detaje që lidhen me modelet e tipit cookie, ju lutemi të aksesoni Politikat e cookies që janë të disponueshme në website-in e iSense.

Arsyeja e përpunimit: interes legjitim në përputhje me parashikimet e Ligjit 506/2004.

B. Për ***qëllimin*** e menaxhimit të kërkesave që transmetohen nëpërmjet formularëve të kontaktit, të kërkuarit e informacioneve plëtësuese dhe/ose reklamime/ankesa në website-in e iSense.
Arsyeja e përpunimit: interes legjitim.

2. Në qoftë se jeni të abonuar për të pritur informimet me interes komercial/tregëtar, të cilat i transmetojmë përmes e-mail-it (*aktivitet të cilin e quajmë në vazhdimësi "Newsletter"*), do të mund të procesojmë të dhënat tuaja me qëllim marketingu, për t'u dërguar, nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë (për shembull, për të mos u kufizuar vetëm me e-mail, telefon, mesazhe me tekst), por edhe nëpërmjet platformës dixhitale të komunikimit, të tipit newaletter, ose mesazhe të tjera tregëtare që lidhen me prodhimet dhe me shërbimet i Sense, partanerëve dhe kompanive që bashkëpunojnë me ne.
Arsyeja e i përpunimit: *përmes dhënies së dakortësisë suaj*

ËSHTË E RËNDËSISHME TË MBAHET PARASYSH: se aprovimi juaj për aktivitetet e marketingut në mënyrë direkte, mund të tërhiqet në çdo moment, pa asnjë lloj kostoje për ju. Por duhet të mbahet parasysh fakti se tërheqja e dakortësisë suaj do të prodhojë efekte për të ardhmen, por pa u prekur legaliteti i përpunimit të të dhënave që është kryer përpara momentit të tërheqjes.

2. Në qoftë se jeni një person i tretë, pa asnjë rol apo cilësi të një klienti të ardhshëm potencial apo të një klienti faktik, pavarësisht nga mënyra se si keni hyrë në kontakt me iSense, do të mund të procesojmë të dhënat tuaja me karakter personal;

A. Në lidhje me respektimit të detyrimeve ligjore për qëllimet si më poshtë:
- zgjidhja e kërkesave/ankesave që lidhet me ushtrimin e të drejtave që i përfitoni në kontekstin e procesimit të të dhënave me karakter personal, gjë që parashikohet në legjislacionin në fuqi;
- menaxhimi i marrëdhënieve me autoritetet publike apo me institucione të tjera të së drejtës publike dhe/ose private, që kryejnë një shërbim publik.
  Arsyeja e përpunimit: *detyrimi ligjor*.

B. Në lidhje me përmbushjen e interesave legjitime të iSense që kanë si qëllime si më poshtë:
- konstatimin, ushtrimin apo mbrojtjen e disa të drejtave të iSense në gjykatë, si dhe në çdo lloj procedurë gjyqësore;
- aksesimin online të lajmërimeve dhe informacioneve të reja;
- dërgimin e përgjigjeve për kërkesat tuaja;
- sigurimin e sigurisë së infrastrukturës informatike në zyrën qëndrore të iSense apo në pikat e punës së iSense;
- sigurimin e sigurisë dhe mbrojtjes së personelit (ekipit) të iSense;
- menaxhimin e çdo lloj kërkese, ankese apo sugjerimi.
- Arsyeja e përpunimit: *interesi legjitim.*

3.NË CILËSINË E PËRDORUESIT të platformës iSense (përdorues aktual ose ish përdorues), do të mund të procesojmë të dhënat tuaja me karakter personal mënyrat që vijojnë:

2.1. Në rastin kur ju keni hapur një kont/llogari si përdorues i platformës iSense:

A. Në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore për qëllimet si më poshtë:

- Përmbushja e detyrimeve financiare, të kontabilitetit dhe fiskale, duke përfshirë edhe hartimin e evidencave kontabile, ruajtja e dokumenteve që justifikojnë dhe që qëndrojnë në bazë të regjistrimeve kontabile;
- Zgjidhja e kërkesave /ankesave që lidhen me ushtrimin e të drejtave që ju përfitoni në kontekstin e procesimit të të dhënave me karakter personal;
- Arkivimi i dokumentave në përputhje me dispozitat ligjore si dhe duke respektuar afatet e centralizimit në arkivën i Sense;
- Menaxhimi i marrëdhënieve me institucionet publike apo me institucione të tjera të së drejtës publike dhe/ose private që kryejnë shërbime publike;
- Tuatja e regjistrve të ndryshëm, evidenca, formularë, në përputhje me dispozitat e ligjeve speciale;

  Arsyeja e procesimit: *detyrim ligjor.*

B. Në lidhje me nënshkrimin dhe ekzekutimivt e kontratave për qëllimet si më poshtë:

- Marrja dhe procesimi i kërkesave tuaja për nënshkrim kontrate, në mënyrë direkte nga ju ose në mënyrë jo direkte, nëpërmjet një punonjësi të iSense ose nëpërmjet një personi të tretë që ka rolin e ndërmjetësit kontraktues/ose të autorizuar nga iSense për të menaxhuar marrëdhëniet me iSense (i fuqizuar nga iSense);
- Kryerja e shërbimeve të specializuara që ofroniSense, duke përfshirë edhe kontekstin e plotësimit të formularëve për kërkimin e informacioneve që lidhen me realizimin e shërbimeve të kërkuara nga përdoruesi;
- Furnizimi i prodhimeve dhe/ose i shërbimeve që janë kontraktuar në një kontratë;
- Pjesëmarja në studime të cilat presupozojnë plotësimin / ofrimin e përgjigjeve ndaj pyetjeve të pyetsorëve përkatës me karakter të përgjithshëm *("Të dhëna që lidhen me studimin");*
- Faturimi, përkatësisht, rimbursimi i shumave që ju takojnë, transferimi i disa shumave si dhe kthimi mbrapsht i disa shumave;
- Arsyeja e përpunimit: zbatimi deri në fund i një kontrate të nënshkruar midis palëve / respektimi i dispozitave kontraktuale.

- Menaxhimi i përgjigjeve dhe i informacioneve që gjenerohen si rrjedhojë e pjesëmarrjes suaj në studim, gjë që presupozon kompletimin / ofrimin e përgjigjeve të pyetjeve të pytsorëve përkatës me karakter të përgjithshëm *("Të dhëna që lidhen me studimin "me karaketr të specializuar);*

  Arsyeja e përpunimit: *marrja e aprovimit tuaj.*

C. Me synimin për të realizuar interesat legjitime të iSense, ne ndjekim qëllimet si më poshtë:

- Konstatimi, ushtrimi apo mbrojtja e disa të drejtave të iSense në gjykatë, si dhe në çdo lloj procedure gjyqësore;
- Për aksesimin online të informacioneve dhe lajmërimeve që kanë interes;
- Menaxhimi i kërkesave / ankesave që janë marrë në lidhje me zhvillimin / përmbushjen e detyrimeve (të kontratave);
- Dërgimi i përgjigjeve si rrjedhojë e kërkesave që ju keni bërë;
- Sigurimi i infrastrukturës informatike në zyrat / dhe/ose në pikat e punlës së Isense;
- Sigurimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së personelir / ekiit iSense;
- Menaxhimi i çdo lloj kërkese tjetër, ankese apo sugjerimi.

- Aesyeja e procesimit: *interes legjitim.*

3. NË CILËSINË E PËRDORUESIT TË MUNDSHËM të iSense (përdorues i ardhshëm i platformës iSense), do të mund të procesojmë të dhënat tuaja me karater personal në mënyrat si më poshtë:

3.1. Në rastin kur ju dëshironi të regjistroheni në kuadër të platformës iSense:

A. Për nënshkrimin dhe ekzekutimin e kontratave për qëllimet si më poshtë:

- Marrja dhe procesimi i kërkesave për krijimin e një konti/llogarie, kërkesë e bërë nga ju në mënyrë direkte ose në mënyrë jo direkte, nëpërmjet një punonjësi të iSense ose nëpërmjet një personi të tretë që ka rolin e ndrëmjetësuesit (i cili është i fuqizuar/autorizuar me këtë detyrë nga iSense).
- Vënia në dispozicion të studjuesve (studimeve), të pytsorëve të hartuara nga iSense, duke përfshirë edhe studimet që do të zhvillohen në kuadër të portalit iSense, edhe të atyre që dërgohen me e-mail;
- Menaxhimi i kërkesave / ankesave të marra që lidhen me mënyrën se si ecën kontrata, apo me cilësinë e kryerjes së shërbimeve nëpërmjet portalit iSEnse;

Kushti i procesimit*: çuarja deri në përmbushje të plotë të formaliteteve parakontraktore (ekzekutimi korrekt i një kontrate(/ respektimi i parashikimeve të kontratës.*

B. Në lidhje me përmbushjen e ineteresave legjitime të iSense, ne ndjekim këto qëllime:

- konstatimin, ushtrimin apo mbrojtjen e disa të drejtave të Isense në gjykatë, si dhe në çdo lloj procedure gjyqësore;
- në kontekstin e përpunimit të të dhënave me karakter personalpër programimet telefonike;
- aksesimin online të informacioneve dhe lajmërimeve që kanë interes;
- dërgimin e përgjigjeve si rrjedhojë e kërkesave që ju keni bërë;
- Sigurimi i infrastrukturës informatike në zyrat / dhe/ose në pikat e punlës së Isense;
- Menaxhimi i çdo lloj kërkese tjetër, ankese apo sugjerimi.
  Arsyeja e procesimit: *interes legjitim.*

NË LIDHJE ME FURNIZUESIT TANË

Mund të lejojmë që të dhënat tuaja me karakter personal të procesohen nga partenerët tanë (që na janë bashkuar, nga furnizorët apo bashkëpunëtorët tanë), me synimin për të përmirësuar shërbimet apo produktet që ne ju ofrojmë. Përpara se këtyre të fundit t'u lejojmë që të bëjnë procesimin e të dhënave me karakter personal, ne do të sigurohemi nëse kemi nënshkruar një kontratë me ta e cila i detyron këta që të implementojnë masa të përshtashme për sigurinë e të dhënave me karakter personal që ju na i besoni dhe të cilat ne i përpunojmë ne emrin tuaj dhe për ju.

Ne mund t'u lejojmë aksesin dhe/ose dërgimin e të dhënave me karkater personal organizatave me të cilat i kontraktojmë dhe të cilat ofrojnë shërbime në interesin e iSense.

Lista e mëposhtëme përfshin kategoritë në të cilat bëjnë pjesë furnizorët tanë:

- shërbime interneti (për shembull, për të mos u kufizuar vetëm në strehën web apo në atë të e-mail);
- Që bëjnë shërbime marketingu.
- Që bëjnë sponsorizimne, konkurse, promocione, shortee.
- Që kryejnë shërbime të analizës së të dhënave,
- Që kryejnë shërbime kontabiliteti.
- Që ofrojnë shërbime të sigurisë informatike
- Që ofrojnë shërbime të mirëmbajtjes dhe funksionimit IT&C (kompjutera).
- Që ofrojnë shërbime për klientët,
- Që ofrojnë shërbime që lidhen me studime dhe/ ose hetime të tregut si dhe me nivelin e kënaqshmërisë së klientëve.
- Që oforjnë shërbime auditimi/kontrolli financiar.

Në lidhje me **ZBATIMIN E LIGJIT, KONFORMITETIN DHE SIGURIMIN**

Në kuadrin e bashkëpunimeve që kemi me organizatat e tjera në kuadër të proiektit iSense, ne mund të vëmë në dispozicion të përfaqësuesve të këtyre të dhëna me karakter personal që ju përkasin juve. Në kuadrin e bashkëpunimeve që ne kemi me secilën nga këto organizata, ne sigurohemi, së pari, që këto organizata implementojnë një seri minimale masash sigurimi, në mënyrë të atillë që të dhënat tuaja me karakter personal të jenë të mbrojtura gjatë gjithë kohës dhe në rastin e një fuzioni apo riorganizimi tonën të kemi mundësi që këto të dhëna me karakter personal, që ju përkasin juve, të cilat na janë dërguar në bazë të aprovimit tuaj, t'i transferojmë në një afat të përshtatshëm.

Në lidhje me **TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE ME KARAKTER PERSONAL**

Në rastin kur do të jemi të detyruar të lejojmë aksesin apo të transferojmë të dhënat tuaja me karkater personal autoriteteve publike ose qeveritare, kombëtare apo europiane , për arsye të sigurisë kombëtare, dhe duke zbatuar legjislacionin në fuqi ose për arsye të një rëndësie publike, ne do të marrim të gjitha masat që t'ju lajmërojmë në kohë çdo herë që të jetë e nevojshme dhe sa herë të na lejojë ligji.

Në qoftë se, me mirëbesim, konsiderojmë se zbulimi i të dhënave tuaja me karakter personal është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave tona, për zgjidhjen e konflikteve juridike, apo për të hetuar një shkelje/kundravajtje, për të mbrojtur përdoruesit tanë, klientët apo punonjësit ose për të respektuar afatet dhe kushtet, do të bëjmë gjthçka që është e mundur për t'ju njoftuar në një interval kohe të arsyeshme, i cili nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në situatën në të cilën e konsiderojmë se është i nevojshëm transferimi i të dhënave tuaja me karakter personal jashtë hapësirës ekonomike europiane (e quajtur në vazhdimësi SEE), iSense, si dhe furnizuesit ose partenerët që ajo ka kontraktuar, do t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë mënyrave se si këto të dhëna me karakter personal do të jenë të procesuara, ndërkohë që çdo lloj transferimi i të dhënave me karakter personal do të kryhet vetëm drejt destinacioneve (vendeve) dhe drejt kompanive të cilat përdorin masa suplementare të sigurisë dhe të cilat paraqesin një komplet të mjaftueshëm garancish që lejojnë që i gjithë procesi i përpunimit të të dhënave me karakter personal të zhvillohet në kushtet e një sigurie maksimale.

TË DREJTAT

1. e drejta e informimit dhe e aksesit në date me karkater personal	Kjo e drejtë ju lejon të merrni konformimin e faktit se të dhënat tuaja personale janë të procesuara nga ne dhe se cilat nga këto të dhëna janë të nevojshme për aktivitetin e përpunimit të tyre.
2. e drejta për të korrektuar të dhënat me karakter personal	Kjo e drejtë ju lejon që të korrigjoni të dhënat tuaja me karakter personal nëse këto janë jo korrekte.
3. e drejta për të fshirë të dhënat me karakter personal	Kjo e drejtë ju lejon që të realizoni fshirjen e të dhënave tuaja personale në disa raste të veçanta: • në qoftë se të dhënat tuaja nuk janë më të nevojshme në lidhje me qëllimin për të cilat janë mbledhur. • Në qoftë se procesimi i të dhënave është bërë me aprovimin tuaj dhe nëse ju keni tërhequr aprovimin tuaj ose në rastin në të cilin nuk ekzistojnë bazat ligjore për procesimin e të dhënave tuaja personale; Në qoftë se vërtetohet se të dhënat tuaja personale janë procesuar në mënyrë ilegale;
4. e drejta për të kufizuar procesimin e të dhënave me karakter personal	Kjo e drejtë ju lejon të kufizoni procesimin e të dhënave tuaja me karakter personal në raste të veçanta (për shembull, në rastin kur kundërshtoni saktësinë e të dhënave tuaja me karakter personal, për një periudhë kohe që na lejon të verifikojmë saktësinë e të dhënave).
5. e drejta për transferimin e të dhënave me karkater personal	Kjo e drejtë ju lejon që të merrni të dhënat me karakter personal që na i keni furnizuar, në një format të strukturuar, që përdoret shpesh dhe që lexohet lehtë, ose mund t'ia dërgoni këto të dhëna një operatori tjetër të dhënash;
6. e drejta për të bërë kundërshtimin tuaj	Kjo e drejtë ju lejon që të kundërshtoni procesimin e mëpasshëm të të dhënave tuaja me karakter personale në kushtet e parashikuara nga ligji;

7.	e drejta për të bërë një ankim tek autoriteti mbikqyrës dhe/ose në një institucioni gjyqësore	Kjo e drejtë ju lejon që të dërgoni një ankesë tek ANSPDCP – Autoriteti Kombëtar i Mbikqyrjes së Procesimit të të Dhënave me Karakter Personal ose t'i dërgoni ankesën një institucioni gjyqësor
8.	e drejta e informimit dhe e aksesit në date me karkater personal	Kjo e drejtë ju lejon të merrni konformimin e faktit se të dhënat tuaja personale janë të procesuara nga ne dhe se cilat nga këto të dhëna janë të nevojshme për aktivitetin e përpunimit të tyre.

Për t'ju përgjigjur kërkesave tuaja që lidhen me ushtrimin e të drejtave që garanton legjislacioni në fuqi në drejtimin e mbrojtjes së të dhënave me karakter personal në një kohë sa më të shkurtër të mundur, ju rekomandojmë që t'i drejtoheni direkt zyrës DOP pranë iSense, duke i adresuar një e-mail në adresën si më poshtë: dpo@sensepanels.com ose mund të dërgoni mesazhin tuaj me anë të një letre të shkruar, të cilën do ta dërgoni në adresën postale të korespondencës: str.Occidentului nr. 3, et. 3, kodi postal 010981, Sector 2, Bukuresht, Rumani (në godinën e Ivy Office).

Ju lutemi të keni parasysh se të drejtat e numëruara më lart nuk janë absolute, mbasi ekzistojnë edhe përjashtime, por ju premtojmë se menjëherë me marrjen e një kërkese do ta analizojmë arsyen e kësaj kërkese dhe më pas do të marrim edhe një vendim që do të lidhet me shkakun e saj. Në rastin kur kërkesën tuaj e gjejmë të bazuar, atëhere do të merremi me zgjidhjen e saj që ka të bëtë me ushtrimin nga ana juaj të të drejtave. Por, në rastin kur kjo kërkesë NUK është e bazuar, atëhere ne kemi të drejtën për ta refuzuar atë, në këtë situatë ju sigurojmë se do t'ju informojmë mbi arsyet e refuzimit tonë, duke ju informuar, njëkohësisht, mbi të drejtën tuaj për t'ju drejtuar Autoritetit të Mbikqyrjes si dhe për t'iu drejtuar organeve gjyqësore.

ËSHTË E RËNDËSISHME QË TË MBANI PARASYSH: në rastin kur, me gjithë përpjekjet tona, nuk arrijmë t'ju identifikojmë, ndërkohë që ju nuk na furnizoni me informacione suplementare, me qëllimin për të përmbushur procedurën e identifikimit korrekt, ne kemi të drejtën për të çuar më tutje kërkesën përkatëse.

Afati i përgjigjes për çdo kërkesë tuajën që ne do të marrim është 30 ditë. Por, duam që t'ju informojmë për faktin se ky afat mund të zjgatet për shkak të aspekteve të ndryshme, siç mund të jetë kompleksiteti i kërkesës suaj, numri shumë i madh i kërkesave në përgjithësi, ose pamundësia jonë për t'iu identifikuar në një interval kohe të arsyeshme.